



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 289, datë 18.12.2019

PËR

CAKTIMIN NË POZICION, NË MËNYRË TË PËRHERSHME, NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR TË GJYQTARES ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 135, pika 4, nenin 147, pika 1, nenin 147/a, shkronja “a” dhe nenin 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 162, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi shqyrtoi relacionin përkatës dhe materialet e nevojshme, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtares në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda znj. {...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR